



**VENDIM**

**Nr. 38 Datë 15.04.2011**

**PËR  
FILLIMIN E PROÇEDURAVE TË LICENSIMIT TË  
SHOQËRISË “GSA ” SH.P.K NË AKTIVITETIN E TREGËTIMIT  
TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 13 pikat 1, gërma “d”, dhe 8, të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, nenit 10 pikat 1 dhe 3 të “Rregullores për procedurat e liçensimit, modifikimit, transferimit të plotë /të pjesshëm dhe rinovimit të liçensave”, të miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr.108 datë 09.09.2008, dhe nenit 18 pikat 1, gërma “a” dhe 3, të “Rregullave të Praktikës dhe Proçedurave të ERE-s”, miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerve, Nr.21, datë 18.03.2009, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 15.04.2011, mbasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë “GSA” sh.p.k për liçencim në aktivitetin e Tregëtimit të Energjisë Elektrike,

**Konstatoi se :**

Aplikimi i shoqërisë “GSA” sh.p.k plotëson kërkesat e parashikura nga ERE në rregulloren për procedurat e liçensimit, modifikimit, transferimit të plotë /të pjesshem dhe rinovimit të liçensave si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1, gërma a, b dhe c) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, gërma a,b,c,d,f dhe g) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni finaciari dhe fiskal (neni 9, pika 3, gërma a, b dhe d) janë paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni teknik (neni 9, pika 4.10, gërma a, b, dhe c ) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.



**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**ENTI RREGULLATOR I ENERGJISE**  
Bordi i Komisionereve



Për gjithë sa më sipër cituar Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

**Vendosi:**

1. Fillimin e procedurave të shqyrtimit të aplikimit të të shoqërisë “GSA” sh.p.k për licensë në aktivitetin e Tregëtimit të Energjisë Elektrike.
2. Drejtoria e Licensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftoj aplikuesin për Vendimin e Bordit të Komisionereve të ERE-s

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.



Votimi i Bordit të Komisionerëve të ERE-s për,

**VENDIM**

*Nr. 38 Datë 15.04.2011*

**PËR  
FILLIMIN E PROCEDURAVE TË LICENSIMIT TË  
SHOQËRISË “GSA” SH.P.K NË AKTIVITETIN E TREGËTIMIT  
TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Anëtarët e Bordit

|                | Pro   | Kundër |
|----------------|-------|--------|
| Entela Shehaj  | _____ | _____  |
| Ardian Haçi    | _____ | _____  |
| Abaz Aliko     | _____ | _____  |
| Shkelqim Bozgo | _____ | _____  |